

# PSE KASTROHEN DHE STERILIZOHEN QENTË E RRUGËS?



# ÇKA ËSHTE KASTRIMI DHE STERILIZIMI?

- Kastrimi te qentë meshkuj dhe sterilizimi te qentë femra nënkupton heqjen e organeve riprodhuese (testikujt, vezoret apo mitra me vezore) për të ndalur mundësinë e shumimit të genit, do të thotë: **për të ndaluar mundësinë e lindjeve të këlyshëve.**



## KASTRIMI/STERILIZIMI TE QENTË E RRUGËS

- Kastrimi dhe sterilizimi** për qentë e rrugës është shumë i rëndësishëm dhe shërben si **masë e ndalimit të riprodhimit të qenve në rrugë**, duke parandaluar kështu rritjen e numrit të tyre përmes shumimit.

## ÇKA ËSHTE METODA KSVL?

- KSVL (kap, sterilizo/kastro, vaksinio, lësho)** është një masë e kontrollit të riprodhimit të qenve endacak, që rregullohet me dispozitën ligjore - *Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) 04/2017 Për Kushtet Teknike Të Cilat Duhet Plotësuar Qendrat E Trajtimit Të Përkohshëm Të Kafshëve Endacake.*
- KSVL nënkupton procesin e trajtimit të qenve për të ndaluar riprodhimin e tyre**, duke filluar nga kapja e qenve në rrugë, transporti i tyre tek klinika veterinare, vaksinimi kundër tërbimit, ndërhyrja kirurgjike për heqjen e organeve riprodhuese (kastrimi/sterilizimi), trajtimi kundër parazitëve të brendshëm dhe të jashtëm, periudha e hospitalizimit **nga 5-7 ditë**, dhe kthimi i tyre në vendin ku janë kapur.
- Qentë lirohen prapë në rrugë** për të jetuar me komunitetin pasi që ndërtimi i strehimoreve në shtetet ku ka shumë qen në rrugë, nuk është efikas dhe as i qëndrueshëm dhe nga shumë shembuj tjerë në vendet fqinje me situatë të njëjtë, ndërtimi i strehimoreve është konsideruar si shpenzim i madh i parasë publike, pa e zgjidhur fare problemin.

- ♦ **KSVL** është masa më efikase dhe humane për të reduktuar mbipopullimin e qenve në rrugë, dhe për të parandaluar përhapjen e sëmundjes së tërbimit në popullsinë e qenve.
- ♦ **Metoda KSVL duhet të përdoret si masë e përbashkët me masa tjera** të cilat fokusohen në burimet e problemit të rritjes së numrit të qenve në rrugë dhe me vlerësime dhe monitorime të gjendjes, **për menaxhimin e suksesshëm të popullsisë së qenve.**

## PSE KSVL SI MASË NË KOSOVË?

Duke marrë parasysh numrin e madh të qenve endacak në Kosovë, metoda KSVL shërben si një masë e rëndësishme për të parandaluar rritjen e numrit të qenve në rrugë përmes shumimit.

Meqenëse ka mungesë të strehimit adekuat të kafshëve, dhe ende nuk ka veprime konkrete që adresojnë burimet kryesore të rritjes së numrit të qenve në rrugë (braktisjet, mbarështimi dhe shitja e pakontrolluar), KSVL është masë e domosdoshme për kontrollin dhe stabilizimin e numrit të kafshëve në rrugë.

Qentë janë kafshë me aftësi të larta riprodhuese. Sipas studimeve, nga një çift i qenve, brenda 5 viteve, mund të lindin deri në 50,000 qen.



# MATJA E NDËRHYRJEVE TË KSVL NË POPULLSINË E QENVE ENDACAK

Për të pasur sukses metoda KSVL, duhet të shoqërohet me vlerësime të popullsisë dhe dinamikës së qenve endacak, para, gjatë dhe pas projekteve të KSVL-së.

Në mënyrë që të dizajnohen masat më efektive, vlerësimi i dinamikës (numri i qenve në rrugë, mirëqenia e qenve, numri i qenve femra në laktacion, numri i këlyshëve) së popullsisë së qenve është i domosdoshëm.

Monitorimi i trajtimit të qenve gjatë projekteve komunale të KSVL është po ashtu tejet i rëndësishëm. **Qentë e trajtuar duhet të kthehen në territorin e njejtë ku janë kapur.**

Mirëqenia e qenve duhet të respektohet në maksimum gjatë trajtimit të tyre në klinikat veterinare. Qëndrimi i qenve në qendër gjatë periudhës post-operative nuk duhet të jetë stresues në asnjë mënyrë, pasi që çfarëdo përvojë negative gjatë qëndrimit në qendër, mund të ndikojë negativisht edhe në sjelljet e qenve në rrugë, sidomos në raport me njerëzit.



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fondacija za prava životinja

[WWW.ANIMALRIGHTS-RKS.ORG](http://WWW.ANIMALRIGHTS-RKS.ORG)  
[INFO@ANIMALRIGHTS-RKS.ORG](mailto:INFO@ANIMALRIGHTS-RKS.ORG)